



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Financë Kontabilitet”**

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor i Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Adrian Civici, Prof. Dr.

2. Arjan Kadareja, Prof. Assoc. PhD

Korrik/2019



## PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Një grup i vlerësimit të jashtëm, i kontraktuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, zhvilloi një vizitë dy ditore në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit të Universitetit Bujqësor të Tiranës. Vizitat u zhvilluan në kuadrin e procesit të akreditimit të parë për Programin e Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Financë Kontabilitet”.

Procesi i vlerësimit të jashtëm kryhet nga vlerësues që nuk janë të përfshirë në aktivitetin e Institucionit të Arsimit të Lartë, pjesë përbërëse e programeve të të cilit është edhe programi i studimit, objekt i procesit të vlerësimit.

Gjatë këtij procesi, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga institucioni përgjegjës i programit të studimit si edhe nga vizitat dhe komunikimi në terren, vlerësohet shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë nga ana e programit të studimit. Standardet ndahen sipas gjashtë fushave kryesore të cilësisë.

Anëtarët e këtij grupi vlerësues kanë eksperiencë akademike e mësimdhënieje në Institucionet e Arsimit të Lartë si edhe kanë marrë pjesë në një seancë të dobishme trajnimi të zhvilluar nga ekspertët e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Në fund të procesit vlerësohet shkalla e përbushjes së standardeve, përcaktohen pikat e forta, ato të dobta si edhe jepen rekomandimet për përmirësim.



### **Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm**

Procesi i vlerësimit të jashtëm është pjesë përbërëse e akreditimit të parë për Programin e Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Financë Kontabilitet”.

Programi i studimit është nën përgjegjësinë e Departamentit Financë Kontabilitet të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit në Universitetin Bujqësor të Tiranës.

Baza e nisjes së procesit ishte dokumentacioni i plotë i veprimtarive të programit si edhe raporti i vlerësimit të brendshëm, i hartuar nga grupi i punës i Departamentit Financë Kontabilitet.


Mbas shqyrtimit të dokumentacionit dhe raportit të vlerësimit të brendshëm, procesi vazhdoi më tej me dy vizita që u kryen në Institucion në ditët 24 dhe 27 Maj, 2019.

Gjatë vizitave u kryen takime dhe intervista të shumta me hartuesit e raportit të vlerësimit të brendshëm, me personelin drejtues, me personelin akademik, me studentët dhe personelin administrativ. Grupi zhvilloi edhe disa takime të zgjeruara me grupe përfaqësuese të përfshira në program.

Gjatë vizitave u krye edhe shqyrtimi fizik i të gjitha ambienteve të Institucionit kryesor dhe atij bazë përgjegjës për programin e studimit.

Qëllimi i vizitave ishte njohja në thellësi e institucionit përgjegjës kryesor dhe atij bazë për programin e studimit si edhe verifikimi në vend i saktësisë së dokumentacionit dhe raportit të vlerësimit të brendshëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm u prit mjaft mirë nga personeli i institucionit dhe i falenderon përzemërsisht të gjithë për bashkëpunimin e plotë dhe transparent gjatë gjithë këtij procesi. Gjatë gjithë procedurës ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë asistuar nga Kordinatori Teknik i ASCAL, Z. Erjon Xhako.

Më datë 15.07.2019 me anë të sistemit AMS dhe me shkresë Nr.44/44 prot. dërgohet në Institucion Draft Raporti i Vlerësimit të Jashtëm i hartuar nga ekspertet e vlerësimit. Më datë 18.07.2019, Institucioni ktheu përgjigje me anë të sistemit AMS dhe me shkresë Nr. 216 prot. Dt.16.07.2018 në lidhje me Draft Raportin, ku shprehet se **nuk ka komente** në lidhje me të. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



**Vlerësimi I Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Financë Kontabilitet”**


**I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR**

<b>Standardi I.1</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Referuar dokumentit themelor me titull “PLANI STRATEGJIK I MANAXHIMIT TE UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS (UBT) 2016-2025”, (faqe 5-7) si dhe vlerësimit të drejtpërdrejtë nga vizita në Institucion, konstatohet se Programi i studimit i ofruar nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, nuk bie ndesh me interesat kombëtare.			
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Referuar dokumentit themelor me titull “PLANI STRATEGJIK I MANAXHIMIT TE UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS (UBT) 2016-2025”, si dhe vlerësimit të drejtpërdrejtë nga vizita në Institucion, arrihet në përfundimin se Programi i studimit i ofruar, synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave kulturore kombëtare.			
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Referuar dokumentit themelor me titull “PLANI STRATEGJIK I MANAXHIMIT TE UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS (UBT) 2016-2025” (faqe 5-7), si dhe vlerësimit të drejtpërdrejtë nga komunikimi në Institucion me drejtuesit e Fakultetit dhe Departamentit përkatës, konkludohet se Programi i studimit është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë së tij.			
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Referuar Strategjisë së UBT-së dhe dokumentit “Plani Strategjik i Ciklit të Parë për Programin Financë Kontabilitet: 2016-2025, si dhe vlerësimit të drejtpërdrejtë nga komunikimi në Institucion, arrijmë në përfundimin se programi i studimeve është hartuar dhe zhvillohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal e kombëtar. Dokumenti i cituar më sipër reflekton përmirësime të evidentueshme kundrejt dokumentit të mëparshëm të Planit strategjik të ciklit të parë për Programin Financë-Kontabilitet 2007-2012.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe	Mbështetur në Statutin bazë të UBT, (faqe 31-37), si dhe nga verifikimi i drejtpërdrejtë në Institucion, konstatohet se programi i studimit Financë-Kontabilitet është hartuar dhe ofrohet në

ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.			
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Mbështetur në Rregulloren e Brendshme të programit “Financë-Kontabilitet (2017) dhe Statutin bazë të Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT), konstatohet se në programin e studimit janë përcaktuar qartë drejtimet prioritare akademike. Gjithashtu evidentohet se ky program studimi është hartuar dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të Rregullores së Brendshme dhe Statutit bazë të UBT-së.			
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.	Mbështetur në Rregulloren e Brendshme të programit “Financë-Kontabilitet (2017) dhe Statutin bazë të UBT-së, si dhe vlerësimin të drejtpërdrejtë nga komunikimi në Institucion, arrijmë në përfundimin se organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohet në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të Institucionit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	Referuar Rregullores së Brendshme të programit “Financë-Kontabilitet (2017) si edhe dokumentit KURRIKULA E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË (BACHELOR), Profili: “Financë Kontabilitet”, konstatohet se ky program studimi ka objektiva të përcaktuara qartë ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të studimeve.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e	Referuar dokumentit me titull ANALIZË E NEVOJAVE TË TREGUT PËR HAPJEN / ZHVILLIMIN E PROGRAMIT BACHELOR NË FINANCË KONTABILITET, PRANË FAKULTETIT TË EKONOMISË DHE AGROBIZNESIT të UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS, si edhe qartësimeve përkatëse nga vizita në Institucion, konstatohet se departamenti i Financë Kontabilitet ka kryer analiza specifike në lidhje me kërkesat e punësimit në tregun lokal dhe ndërkombëtar për të diplomuarit e këtij programi studimi. Sipas akt-marrëveshjeve me shoqatat e biznesit (Referuar dokumentit me titull Akt-Marrëveshje), konstatohet se studimet e tregut të




punësimin të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	punës përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimin të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.			
<b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	Sipas akt-marrëveshjeve me shoqatat e biznesit (referuar dokumentave me titull Akt-Marrëveshje, Lista e sipërmarrjeve, organizatave dhe institucioneve me të cilat Universiteti Bujqësor i Tiranës ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi), Rregullores DZHKKVI & DITNJ (2017) dhe qartësimeve në komunikimin e drejtpërdrejtë në Institucion, arrijmë në përfundimin se objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit dhe rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>

<b>Standardi I.4</b> <b>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.	Departamenti Financë Kontabilitet e ofron Programin e Ciklit të Parë Financë Kontabilitet prej 11 vjetësh. Personeli akademik përbëhet nga 4(katër) Prof. Dr., 3(tre) Prof. Assoc., 8(tetë) Doktorë Shkencash, 1(një) Doktorant dhe 1(një) MSH. Pjesa më e madhe e personelit akademik e ka formimin në fushën e finance kontabilitetit. Pjesa më e madhe e publikimeve të personelit akademik është në fushën e financë kontabilitetit. Disa anëtarë të personelit me titull <i>Profesor</i> kanë përvojë të gjatë shërbimi në borde dhe Institucione bankare e financiare të tilla si Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, Banka e Shqipërisë dhe Kryesia e Shoqatës së Financierëve dhe Kontabilistëve të Shqipërisë.
<b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Nga verifikimi i dokumentacionit përkatës si edhe nga komunikimi i drejtpërdrejtë me Institucionin, konstatohet se UBT është akoma në proces të kodifikimit të të gjitha programeve të studimit bazuar në LIGJIN Nr. 80/2015 “PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”.




<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit përkatës si edhe nga komunikimi i drejtpërdrejtë me Institucionin, konstatohet se UBT është në proces të kodifikimit të të gjitha programeve të studimit, përfshirë edhe ato ndërdisiplinore, për të gjithë fakultetet bazuar në LIGJIN Nr. 80/2015 “PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p><b>Standardi I.5</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Konstatohet se Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit kryen analiza vjetore mbi ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit. Dokumentat e rregullorë të verifikuara tregojnë se Departamenti Financë Kontabilitet ka detyra e përgjegjësi të tilla si përditësimi i kurrikulës dhe planeve mësimore të çdo moduli të programit të studimit. Në kuadrin e mbarëvajtjes së programit të studimit edhe njësi të tjera kanë përgjegjësitë dhe detyrat e tyre të bashkëpunimit gjë që del nga analizat e përditshme të procesit mësimor si edhe raporti final i analizës mësimore të Institucionit</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Nga verifikimi i marrëveshjeve egzistuese të Institucionit, kundrejt kërkesave të këtij kriteri, konstatohet se ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit si edhe me aktorë biznesi (Referuar dokumentit me titull TABELË PËRMBLEDHËSE ME INSTITUCIONET BASHKËPUNUESE, PËR PROGRAMIN E STUDIMIT DHE PËR PRAKTIKËN PROFESIONALE si edhe dokumentit “PËRFITIMET NGA MARRËVESHJET E BASHKËPUNIMIT NË FUNKSION TË REALIZIMIT TË PROGRAMIT TË STUDIMIT”). Referuar kërkesave specifike të këtij kriteri si edhe nga verifikimi i drejtpërdrejtë, vlerësojmë se Institucioni duhet të ketë marrëveshje më të shumta e më substanciale me institucionet homologe të vendit e të huaja.</p>





<b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Nga verifikimi i raporteve analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. (Referuar dokumentit me titull “PËRFITIMET NGA MARRËVESHJET E BASHKËPUNIMIT NË FUNKSION TË REALIZIMIT TË PROGRAMIT TË STUDIMIT”), si edhe nga komunikimi gjatë vizitës, vlerësojmë se Institucioni duhet të ketë raporte më të detajuara dhe më të shpeshta mbi përfitimet nga të tilla marrëveshje.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	Nga verifikimi i marrëveshjeve egzistuese të Institucionit, në lidhje me kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, konstatohet se ka marrëveshje bashkëpunimi me aktorë biznesi (Referuar dokumentit me titull TABELË PËRMBLEDHËSE ME INSTITUCIONET BASHKËPUNUESE, PËR PROGRAMIN E STUDIMIT DHE PËR PRAKTIKËN PROFESIONALE si edhe dokumentit “AKT-MARREVEESHJE” me shoqatën e kontabilistëve). Referuar kërkesave specifike të këtij kriteri si edhe nga verifikimi i drejtpërdrejtë, vlerësojmë se Institucioni duhet të ketë numër më të konsiderueshëm marrëveshjesh të tilla në varësi të programit të studimit.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Konstatohet se është funksionale marrëveshja me shoqatën e kontabilistëve për trajnimin e studentëve që kanë mbaruar programin e studimit. Ky trajnim synon specializimin e mëtijshëm të sapodiplomuarve me qëllim integrimin në tregun e punës.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b> Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe	Konstatohet se programi i studimit është i organizuar në lëndë e module si më poshtë: Lëndë bazë A (5 module), lëndë karakterizuese B (18 module), lëndë ndërdisiplinore C (2 module), lëndë me zgjedhje C (3 module), lëndë plotësuese D (4 module) dhe tezë bachelor E si detyrim përmbyllës. Programi përmban lëndë të organizuara në 31 module (duke mos përfshirë tezën e diplomës dhe praktikën profesionale me një







<p>Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>kohëzgjatje prej 3 (tre) vite akademike. Studentët përmbushin kërkesat për titullin Bachelor në Financë Kontabilitet nëse plotësojnë 180 kredite sipas sistemit European (ECTS) të transferimit të krediteve, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi për arsimin e lartë.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh.</p>	<p>Referuar dokumentit të Institucionit të titulluar KURRIKULA E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË dhe dokumentit RREGULLORE E BRENDSHME E PROGRAMIT BACHELOR "FINANCË KONTABILITET", si edhe nga verifikimi në Institucion, konstatohet se studentët që mbarojnë me sukses programin e studimit diplomohen si "Ekonomistë" të profilit "Financë Kontabilitet".</p> <p>Studentët marrin njohuritë për formimin e tyre si specialistë kontabiliteti dhe finance të njësive ekonomike të vogla e të mesme, sektorit shtetëror si dhe për vazhdimin e studimeve më të avancuara në fushat e financës dhe kontabilitetit.</p> <p>Programi ofron njohuri bazë në mikroekonomi, makroekonomi si edhe njohuritë formuese në lëndët e financës, financave rurale, kontabilitetit, taksimit, bankave, analizës financiare dhe investimeve. Këto dije bëjnë të mundur punësimin e të diplomuarve si specialistë në sektorët e financës, kontabilitetit, agrobiznesit, zhvillimit rural dhe mikrofinancës rurale.</p> <p>Studentët aftësohen për drejtimin e fermave dhe ndërmarrjeve bujqësore, marketing, prodhim bimor e shtazor, drejtim operacional dhe administrim publik.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentit të Syllabus-eve si edhe të dokumentit me titull KURRIKULA E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË, si edhe nisur nga informacioni i verifikuar gjatë vizitës në Institucion se personeli akademik përgjegjës për modulet e mësimin është në kontakt me literaturën bashkohore dhe e vë atë në dispozicion të studentëve. Nga shqyrtimi i syllabuseve dhe komunikimi me pedagogët e studentët, konstatohet se literatura e referuar përfshin edhe atë alternative e kritike ndaj teorive mbizotëruese të fushës. Vlerësojmë se kjo e nxit vlerësimin me sy kritik të teorive të ndryshme nga ana e studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Referuar Syllabus-eve të lëndëve të programit, dokumentit të titulluar RREGULLORE E BRENDSHME E PROGRAMIT BACHELOR "FINANCË KONTABILITET" dhe dokumentit të aplikimit për temë diplome nga studentët, konstatohet se projektet e kursit, temat e diplomës, praktikat mësimore dhe temat kërkimore ku përfshihen studentët më cilësorë synojnë zgjidhjen e problemeve komplekse me të cilat i sapodiplomuari ka të ngjarë të ndeshet në praktikë.</p> <p>GVJ gjeti evidencë se temat e sugjeruara të diplomave synojnë aftësimin e studentëve për zgjidhjen e problemeve të fushave të reja e të preferuara të tregut.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e</p>	<p>Konstatohet se struktura e Programit të studimit sipas dokumentit me titull RREGULLORE E BRENDSHME E PROGRAMIT BACHELOR "FINANCË KONTABILITET" dhe atij me titull KURRIKULA E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË, është në</p>





programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	përputhje me VKM 41, dt. 24.1.2018 (Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë). Përputhja konstatohet referuar karakterit të moduleve, krediteve (ECTS), detyrave e projekteve të kursit, provimeve të ndërmjetme, numrit të studentëve për grup si edhe numrit të grupeve të seminareve për leksion.			
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Konstatohet se programi i studimit i ka përcaktuar qartë veprimtaritë përmes grupimit të lëndëve/moduleve si më poshtë: Lëndë bazë A (5 module) me 17% të numrit total të krediteve (prej 180); Lëndë karakterizuese B (18 module) me 52% të numrit total të krediteve; Lëndë ndërdisiplinore dhe me zgjedhje C (5 module) me 14% të numrit total të krediteve; Lëndë plotësuese D (4 module) me 12% të numrit total të krediteve; Tezë bachelor E si detyrim përmbyllës me 5% të numrit total të krediteve.			
<b>Shkalla e përmbylljes së standardit</b>	<b>Nuk përmbyllet</b>	<b>Përmbyllet pjesërisht</b>	<b>Përmbyllet kryesisht</b>	<b>Përmbyllet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbyllet kërkesat ligjore për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbyllet detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Referuar nenit 23 të ligjit 80/2015 si edhe dokumenteve RREGULLORE e FEA dhe RREGULLORE E BRËNDSHME e DFK, vlerësojmë se Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit si njësi kryesore dhe Departamenti i Financë Kontabilitetit si njësi bazë i përmbyllet detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.	Referuar vendimit për emërimin e koordinatorit si edhe dokumentit të titulluar RREGULLORE E BRËNDSHME e DFK, konstatohet se Prof. Dr F.K, është në rolin e koordinatorit të programit të studimit. Konstatohet gjithashtu se koordinatori i programit e informon rregullisht titullarin e njësisë kryesore.
<b>Kriteri 3.</b> Njësia	Referuar dokumentit të titulluar RREGULLORE e FEA, dokumentit






<p>kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>me titull RREGULLORE E BRËNDSHME e DFK, si edhe nga verifikimi në Institucion, konstatohet se Departamenti i Financë Kontabilitetit është përgjegjës për hartimin dhe zhvillimin e programit të studimit "Financë Kontabilitet"si edhe për propozimin e kriterëve pranues të studentëve. Konstatohet gjithashtu se Departamenti i Financë Kontabilitetit ka një organizim në përputhje me ligjin si edhe ofron një strukturë akademike prej 32 modulesh/lëndësh nën drejtimin e një personeli akademik (me kohë të plotë) prej 4(katër) Prof. Dr., 3(tre) Prof. Assoc., 8(tetë) Doktorë Shkencash, 1(një) Doktorant dhe 1(një) MSH.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Referuar dokumentit me titull TË DHËNA TABELORE PËR PERSONELIN AKADEMIK PËR PROGRAMIN E STUDIMIT, si edhe nga verifikimi në Institucion, konstatohet se Departamenti i Financë Kontabilitetit, si njësi bazë, ka si personel akademik me kohë të plotë 4(katër) Prof. Dr., 3(tre) Prof. Assoc., 8(tetë) Doktorë Shkencash, 1(një) Doktorant dhe 1(një) MSH. Stafit me kohe të pjesëshme perbëhet nga 1(një) Prof., 1(një) Prof. Assoc., 3 (tre) Doktorë Shkencash, 1(një) Doktorant dhe 2 (dy) MSH.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Referuar dokumentit të titulluar RREGULLORE e FEA, dokumentit me titull RREGULLORE E BRËNDSHME e DFK, si edhe nga verifikimi në Institucion, konstatohet se Departamenti i Financë Kontabilitetit është përgjegjës për hartimin dhe zhvillimin e programit të studimit "Financë Kontabilitet"si edhe për propozimin e kriterëve pranues të studentëve.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p><b>Standardi II.3</b></p>	
<p><b>Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumenteve të tilla si Kurrikula Bachelor FK, Struktura e Vitit Akademik, Syllabuset e lëndëve, Ngarkesa Mësimore, si edhe nga verifikimi në Institucion, vlerësojmë se nga njësitë kryesore dhe bazë disponohet informacioni i nevojshëm i programit që përfshin listën e lëndëve/moduleve, tipologjinë, strukturën dhe kreditet. Konstatohet se syllabuset e lëndëve dhe rregulloret përkatëse përmbajnë informacion për ngarkesën mësimore, orët në auditor, rregullat e frekuentimit, provimet, vlerësimin e studentëve, apelimin e notes, etj.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumenteve të tilla si Kurrikula Bachelor FK, Struktura e Vitit Akademik, Syllabuset e lëndëve, si edhe nga verifikimi në Institucion, konstatohet se Programi i studimit Financë Kontabilitet organizohet në lëndë, module si edhe praktikë e aktivitete prodhuese sipas VKM nr 41, datë 24.01.2018 (Për elementët e programeve të studimit të ofruara</p>

	nga IAL).
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Nga shqyrtimi i dokumenteve të tilla si Kurrikula Bachelor FK, Struktura e Vitit Akademik, Syllabuset e lëndëve, si edhe nga verifikimi në Institucion, konstatojmë se Programi i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet është i strukturuar sipas tre viteve dhe gjashtë semestrave, me një ngarkesë prej 24 orësh në auditor secili. Programi i plotë tre vjeçar përmban 180 kredite (ECTS). Struktura e mësipërme, kreditet dhe ndarja e lëndëve sipas semestrave është në përputhje me VKM nr.41, dt.24.01.2018.
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Nga shqyrtimi i dokumenteve të tilla si Kurrikula Bachelor FK, Struktura e Vitit Akademik, Syllabuset e lëndëve, si edhe nga verifikimi në Institucion, konstatojmë se Programi i Studimit Bachelor në Financë Kontabilitet përmban lëndët, modulet, kreditet përkatëse, ngarkesën mësimore, orët brenda e jashtë auditorit, etj. Konstatojmë gjithashtu se personeli akademik përgjegjës e rifreskon planin mësimor në fillim të vitit të ri akademik.
<b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Referuar dokumentit të titulluar RREGULLORE e FEA, dokumentit me titull RREGULLORE E BRËNDSHME e DFK, si edhe nga verifikimi në Institucion, konstatojmë se kandidatë fitues janë ata që kanë përfunduar arsimin parauniversitar të përgjithshëm ose profesional jo më pak se 12 vjet, si dhe që kanë një diplomë shkollë të mesme jashtë vendit të cilët plotësojnë: kriterin e meritës, të rëndësisë, notën mesatare të lëndës së kërkuar me zgjedhje dhe kuotat e lira. Konstatojmë se Njësia kryesore ofron mundësinë për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve ndërmjet programeve të të njëjtit cikël brenda UBT-së ose institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë. Konstatojmë gjithashtu se vlerësimi kryhet në fillim të çdo viti akademik dhe brenda të njëjtit cikël studimesh. Konvertimi i krediteve (ECTS) kryhet në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga studenti i interesuar dhe verifikimit të realizuar nga komisioni Ad Hoc të ngritur nga Njësia kryesore.
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të plotë të Syllabuseve të lëndëve, si edhe nga verifikimi në Institucion, konstatojmë se syllabuset përmbajnë informacionin e duhur në përputhje me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.1.2018.
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen	Nga shqyrtimi i dokumentit me titull RREGULLORE e FEA, si edhe nga komunikimi në Institucion, konstatojmë se në fillim të vitit akademik realizohet procesi i rishikimit të Programit të studimit në lidhje me literaturën, numrin e krediteve (ECTS), raportin leksion/seminar, formatet e kontrollit të dijeve, mjeteve






ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	didaktike dhe mangësive.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Standardi II.4**

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Nga shqyrtimi i dokumenteve të tilla si Kurrikula Bachelor FK, Struktura e Vitit Akademik, si edhe nga verifikimi në Institucion, konstatojmë se ngarkesa e Programit të Studimit Bachelor në Financë Kontabilitet është strukturuar në përputhje me kërkesat e VKM, nr 41, date 24.01.2018.
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	Nga shqyrtimi i dokumenteve të tilla si Kurrikula Bachelor FK, Struktura e Vitit Akademik, Syllabuset e lëndëve, si edhe nga verifikimi në Institucion, vlerësojmë se struktura e Programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet përmban lëndë, veprimtari dhe praktika që i pajisin studentët me njohuri dhe aftësi gjë që mundëson punësimin e tyre me mbarimin me sukses të programit. Në këtë drejtim konstatojmë se një rol të dobishëm luan qendra funksionale e Karrierës dhe Alumni si edhe personeli akademik me rekomandime nga kontaktet me sipërmarrjet.
<b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.	Nga shqyrtimi i dokumenteve të tilla si Kurrikula Bachelor FK, Struktura e Vitit Akademik, Syllabuset e lëndëve, si edhe nga verifikimi në Institucion, vlerësojmë se lëndët e modulet e ofruara, përbërja, struktura, dhe vlerësimi në kredite i Programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet e bën të mundur arritjen e objektivave formuese. Konstatojmë gjithashtu se kryhen rregullisht përditësime të kurrikulës dhe syllabuseve. Këto përditësime vlerësojmë se janë të dobishme për reflektimin e ndryshimeve të tregut të punës.
<b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Nga shqyrtimi i dokumenteve të tilla si Kurrikula Bachelor FK, Struktura e Vitit Akademik, Syllabuset e lëndëve, si edhe nga komunikimi në Institucion, vlerësojmë se struktura dhe elementët përbërës të programit Bachelor në Financë Kontabilitet përputhen me profilin e tij. Vlerësojmë se departamenti i Financë Kontabilitet si njësi bazë ka bërë përpjekje për përafrimin e programit në fjalë me ato të ngjashme ndërkombëtare. Vlerësojmë se ky përafrim duhet të jetë në një shkallë më të lartë.
<b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe	Nga shqyrtimi i dokumenteve të tilla si Kurrikula Bachelor FK, Struktura e Vitit Akademik, Syllabuset e lëndëve,

raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arrijten e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	RREGULLORE E BRËNDSHME e Departamentit të Financë Kontabilitet, si edhe duke ju referuar VKM nr.41, dt.24.01.2018, vlerësojmë se raporti midis formimit teorik dhe praktik të programit e bën të mundur arrijten e objektivave si edhe transferimin e studimeve, mobilitetin dhe punësimin e studentëve pas mbarimit të studimeve.			
<b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Nga komunikimi me Institucionin si edhe nga shqyrtimi i dokumenteve të tilla si Kurrikula Bachelor FK, Struktura e Vitit Akademik, Syllabuset e lëndëve dhe Listës së teksteve/periodikëve të bibliotekës, vlerësojmë se kryhen rregullisht përditësime të lëndëve/moduleve si edhe se literatura e detyruar dhe ndihmëse është jo më e vjetër se pesë vjet.			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	Nga shqyrtimi i dokumenteve të tilla si Syllabuset, Kurrikula Bachelor FK, Struktura e Vitit Akademik, RREGULLORE e FEA, Rregullore e Programit të Studimit Financë Kontabilitet, si edhe nga verifikimi gjatë vizitës në Institucion, konstatohet se përmbajtja e programit përsa i përket lëndëve/moduleve, temave përbërëse e literaturës është në përputhje me nivelin e ciklit të parë në finance kontabilitet. Konstatohet gjithashtu se, në syllabuset e lëndëve, niveli i dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara është në përputhje me programin e studimit Bachelor.			
<b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Nga shqyrtimi i dokumenteve të tilla si Kurrikula Bachelor FK, Struktura e Vitit Akademik, RREGULLORE e FEA, Rregullore e Programit të Studimit Financë Kontabilitet, si edhe nga komunikimi me Institucionin, konstatohet se profili Bachelor në Financë Kontabilitet mundëson punësimin në një sërë pozicionesh pune me sipërmarrjet e industrisë së Agrobiznesit. Konstatohet gjithashtu se është i mundur vijimi i mëtejshëm i studimeve brenda Institucionit ose në Institucione të tjera. Vlerësojmë se ndihmesë në këtë drejtim jep edhe Instituti i Studimeve Ekonomike të Transferimit të Njohurive (ISETNJ) i ngritur pranë Institucionit kryesor.			
<b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Referuar dokumentit Rural Finance Day Program, Marrëveshjes me bizneset, si edhe nga komunikimi në Institucion, konstatohet se kryhen konsultime me sipërmarrjet, nënshkruhen marrëveshje si edhe organizohen aktivitete në lidhje me përditësimin e programit të studimit në përshtatje me kërkesat e tregut të punës.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X




<b>Standardi II.5</b>	
<b>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Referuar dokumentit me titull TË DHËNA TABELORE PËR PERSONELIN AKADEMIK PËR PROGRAMIN E STUDIMIT, si edhe nga verifikimi në Institucion, konstatojmë se Departamenti i Financë Kontabilitetit, si njësi bazë përgjegjëse e programit, ka si personel akademik me kohë të plotë 4(katër) Prof. Dr., 3(tre) Prof. Assoc., 8(tetë) Doktorë Shkencash, 1(një) Doktorant dhe 1(një) MSH. Gjithashtu, konstatojmë se departamenti angazhon edhe pedagogë me kohë të pjesëshme 1(një) Prof., 1(një) Prof. Assoc., 3 (tre) Doktorë Shkencash, 1(një) Doktorant dhe 2 (dy) MSH. (specialistë të fushave përkatëse). Vlerësojmë se personeli akademik i këtij programi i përmbush kërkesat e këtij programi.
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	Referuar dokumentit me titull TË DHËNA TABELORE PËR PERSONELIN AKADEMIK PËR PROGRAMIN E STUDIMIT, si edhe nga verifikimi në Institucion, konstatojmë se Departamenti i Financë Kontabilitetit, si njësi bazë përgjegjëse e programit, ka si personel akademik me kohë të plotë 4(katër) Prof. Dr., 3(tre) Prof. Assoc., 8(tetë) Doktorë Shkencash, 1(një) Doktorant dhe 1(një) MSH. Konstatojmë se kalohet bindshëm niveli minimal i kualifikimit akademik në lidhje me drejtimin e programit dhe mbulimin e moduleve mësimore.
<b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	Referuar dokumentit “Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik në 5 vitet e fundit”, si edhe dokumentit me titull TË DHËNA TABELORE PËR PERSONELIN AKADEMIK PËR PROGRAMIN E STUDIMIT, si edhe nga komunikimi në Institucion, konstatojmë se personeli akademik ka nivel të lartë kualifikimi akademik si dhe se është pjesëmarrës në të paktën një grup kërkimor me botime në vitet e fundit.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe	Nga shqyrtimi i dokumenteve RREGULLORE e FEA, Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet, TABELË PËRMBLEDHËSE ME INSTITUCIONET BASHKËPUNUESE, PËR PROGRAMIN E STUDIMIT DHE PËR PRAKTIKËN PROFESIONALE, dokumentit “AKT-MARREVESHJE” me shoqatën e kontabilistëve, si edhe nga komunikimi në Institucion, konstatojmë se Institucioni vë në dispozicion personelin e duhur, të kualifikuar e të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale. Konstatojmë gjithashtu se personeli udhëheqës i praktikave e temave të diplomave ka kualifikimin e duhur.






veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.				
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Nga vizita ne Insitucion GVJ, konstaton se institucioni siguron personelin ndihmës mësimor shkencor për punët laboratorike dhe mirëmbajtjen e mjediseve mësimore dhe laboratorëve. Personeli ndihmës kademik në FEA përbëhet nga 3 anëtarë ku secili është përgjegjës për dy salla laborator. Ata kujdesen për mirëmbajtjen e mjediseve të laboratorëve dhe mjeteve përkatëse në to.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b> <b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	Referuar dokumentit të “planit të masave për fillimin e vitit”, në Departamentin e Financë Kontabilitetit, si dhe verifikimeve gjatë vizitës në Institucion, rezulton se cdo fillim viti akademik, të gjitha njësitë kyesore në UBT zbatojnë një plan masash, ndër të cilat edhe masa lidhur me kujdesin për zhvillimin e metodave të reja të mësimdhënies. Zyra e Rektoratit, Dekanatet dhe Departamentet përkatëse, angazhohen dhe ngarkohen për zbatimin e planit të masave.
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Referuar dokumenteve përkatëse si edhe verifikimeve gjatë vizitës në Institucion, rezulton se departamenti FK zhvillon procesin e monitorimit të aftësive mësimdhënëse përmes kontrolleve të llojit ‘peer review’. Materialet e kontrolluara tregojnë se gjatë monitorimeve lihen detyra e sugjerime që e përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e	Referuar në mënyrë të detajuar pyetësorëve të realizuar periodikisht me studentët si dhe verifikimeve dhe komunikimit



studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	me studentët gjatë vizitës në Institucion, konstatohet se çështje të caktuara të ngritura nga anketimet e studentëve merren seriozisht nga departamenti FK. Ato reflektohen dhe sjellin përmirësime të procesit të mësimdhënies. Nisur nga rastet e verifikuara, vlerësojmë se ankimet e studentëve marrin vëmendjen e duhur nga ana e personelit akademik e administrativ.			
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Në kuadër të detyrës së Departamentit FK për transparencën dhe publikimin e informacionit, nga verifikimi i dokumentacionit dhe kontrollit në institucion, rezultojnë se strukturat përgjegjëse përkatëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.	Nga verifikimi i dokumentacionit dhe kontrollit në institucion, rezultojnë se DFK është e angazhuar në procesin e promovimit të shembujve dhe praktikave të mira të cilat nxisin dhe motivojnë personelin akademik për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Megjithatë, ky proces duhet dokumentuar në mënyrë më të plotë qoftë si analiza të vecanta, qoftë si protokoll i mbledhjeve të departamentit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi III.2**



**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Referuar pasqyrës për ngarkesën e plotë të stafit akademik në programin Bachelor FK dhe vizitës në institucion konstatohet se DFK aplikon kënaqshëm forma të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive, të konkretizuara në leksione, seminare, detyra kursi, laboratorë, ese, praktika profesionale, etj. U konstatua se ka një përdorim eficient të pajisjeve autovizive në orët e mësimit. Rekomandohet që ky proces të jetë sa më i gjërë dhe më i shtrirë në të gjitha format e mësimdhënies e mësimnxënies. Kërkohe angazhim më i madh për përfshirjen aktive të studentëve në orët e mësimit.
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje	Referuar informacionit të "Udhëzuesit në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve DFK në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit" dhe vizitës në institucion, vlerësohet se DFK e ka në fokusin e punës së tij përmirësimin e metodave të mësimdhënies, mësimnxënies dhe kontrollit të dijeve. Rekomandohet një përpjekje më e madhe dhe e vazhdueshme nga ana e DFK në këto drejtime dhe një pasqyrim më i mirë dokumentar i tyre.

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.	
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	Referuar vizitës në institucion dhe verifikimit të detajuar të informacionit të dhënë në dokumentin me të dhëna të plota për infrastrukturën disponibël të DFK, konstatohet se DFK i plotëson kërkesat e këtij kriteri duke pasur në dispozicion dhe përdorur me efikasitet një bazë të gjerë material didaktike, në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm dhe aplikimit të formave më të reja të mësimdhënies.
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Referuar vizitës në institucion dhe verifikimit të informacionit të dhënë nga DFK në lidhje me kërkesat e këtij kriteri, vlerësohet se personeli akademik i DFK është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit përkatës. Rekomandohet shtimi dhe kompletimi i mëtejshëm i teksteve mësimore bazë me botime të reja, cikleve të leksioneve të parapërgatitura dhe materialeve të tjera ndihmëse për studentët.
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Referuar dokumentacionit të raporteve vjetore të cilësisë së DFK dhe konstatimeve gjatë vizitës në institucion, vlerësohet plotësimi i kërkesave të këtij kriteri nga ana e DFK. Rekomandohet një dinamikë më e plotë dhe pasqyrim më i detajuar në dokumentacion i këtij procesi.
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	Kërkesat e këtij kriteri vlerësohen dhe janë në focus të punës së DFK. Nga vizita në institucion u konstatua se një numër relativisht i madh pedagogësh të DFK ishin të angazhuar për të përdorur metoda interaktive dhe diskutime të hapura për të bërë tërheqëse orët e mësimit.
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Kërkesat e këtij kriteri, bazuar vecanërisht në rregulloren e brendshme për mbikqyrjen dhe vlerësimin e performancës së pedagogëve, vlerësohen dhe janë në focus të punës së DFK. Por nga vizita në institucion u konstatua se mbetet akoma për të bërë në përmirësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies që rrisin autonominë e studentit.





Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	



**Standardi III.3**

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Referuar dokumentit me të dhëna mbi infrastrukturën dhe përdorimin e saj në funksion të programit të studimit bachelor FK, vlerësohet se Procesi mësimor për programin e studimeve Bachelor në Financë Kontabilitet, zhvillohet pranë ambienteve të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit dhe hapësirat janë të mjaftueshme e cilësore duke u mirëmbajtur rregullisht.
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Referuar dokumentit me të dhëna mbi infrastrukturën dhe përdorimin e saj në funksion të programit të studimit bachelor FK, vlerësohet se ambientet e dedikuara për procesin mësimor nga ana e DFK janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor duke plotësuar kriteret teknike edhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme, referuar normativës së përcaktuar në VKM.Nr.418, date 10.05.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucionineve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre”.
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Referuar dokumentit me të dhëna mbi infrastrukturën dhe përdorimin e saj në funksion të programit të studimit bachelor FK dhe vizitës në institucion, u konstatua se DFK ka bërë përpjekje të vlerësueshme për plotësimin me salla, ambjente, programe e laboratorë kompjuterike për të realizuar leksionet, seminarët e praktikant në module të caktuara.
<b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Referuar udhëzuesit për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit dhe përdorimin e saj në funksion të programit të studimit bachelor FK dhe vizitës në institucion, u konstatua se DFK ka vënë në dispozicion të studentëve literaturë bazë e ndihmëse që garantojnë marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.
<b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të	Referuar listës së teksteve dhe periodikëve, në funksion të programit Bachelor FK, dhe vizitës në institucion konstatohet se DFK ka vënë në dispozicion të studentëve nëpërmjet bibliotekës të UBT dhe FEA, tekste mësimore të përcaktuara në syllabuse-t e lëndëve dhe




fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	literaturës ndihmëse të nevojshme. Rekomandohet një punë më e vazhdueshme në shtimin e fondit të librave dhe literaturës specifike, sidomos në gjuhë të huaj e cila duhet të reflektojë ndryshimet dhe përmirësimet e programit të studimit dhe përshtatjen me zhvillimet bashkëkohore në këtë drejtim.			
<b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Vlerësohet se në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët e DFK kanë mundësi të aksesojnë libraritë on-line TEEAL që zotëron UBT. Stafi akademik mund ta aksesojë këtë librari nga zyrat, ndërkohë që studentët mund ta aksesojnë nga biblioteka. Megjithatë, numri i përdoruesve, staf pedagogjik apo student mbetet i kufizuar.			
<b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Vlerësohet se në DFK, infrastruktura laboratorike e domosdoshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë relativisht eficiente nga studentët. Rekomandohet vëmendje më e madhe në këtë drejtim nga ana e DFK për rritjen e numrit të studentëve në përdorimin e tyre.			
<b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Vlerësohet se në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët e DFK përdorin platforma on-line (e-learning), megjithëse në numër relativisht të vogël dhe të kufizuar. Rekomandohet vëmendje më e madhe në këtë drejtim nga ana e DFK për rritjen e numrit të personelit akademik dhe studentëve në përdorimin e tyre.			
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Stafi i DFK paraqet në sistemet e komunikimit të brendshëm një dokumentacion të bollshëm elektronik, përfshirë këtu leksionet, rastet studimore, detyrat e kursit, syllabuset, etj.			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Referuar Rregullores së DFK për ciklin e parë të studimeve bachelor, dokumentit mbështetës formulari i plotësuar i zgjedhjes së temës dhe lista e shpërndarjes së udhëheqjes 2017-2018, dhe vizitës në institucion, u konstatua se personeli akademik i DFK orienton studentët në zgjedhjen e temës nëpërmjet një liste paraprake me tema orientuese sipas fushave të kërkimit që mbulon departamenti, si dhe i ndihmon dhe mbështet ata në hartimin e temave të diplomave.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht



				X
--	--	--	--	---

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Referuar Statutit të UBT (neni 26), raporteve vjetore për monitorimin e sigurimit të cilësisë, Raportit vjetor të analizës së punës kërkimore shkencore, si dhe informacioneve të mbledhura gjatë vizitës në institucion, konstatohet se DFK disponon një strukturë të plotë të njësisve në nivel institucional të cilat garantojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, duke u koordinuar e bashkërenduar drejt me njësinë kryesore.
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Referuar RRDFK (kreu II, nenet 8 dhe 9), DFK, si njësi mësimore kërkimore bazë, përfshin fusha kërkimi të konsoliduara, të organizuara grupe specifike kërkimore, të cilat ndjekin dhe bashkërendohen në aktivitetet mësimore e kërkimore brenda departamentit. Veprimtaritë kërkimore bëhen mbi bazën e planeve, programeve dhe projekteve të miratuar, sipas procedurave të statutit të UBT. Rekomandohet një punë më e kujdeshme dhe më konkrete në drejtim të rritjes së vetëdijes së studentëve për problematikën e cilësisë së programeve të studimit që ofron DFK.
<b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Strukturat dhe njësitë përgjegjëse të DFK e kanë në fokusin e punës së tyre eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. Rekomandohet që ky proces të jetë më i gjerë, më i shtrirë në kohë dhe i dokumentuar më mirë.
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Gjatë vizitës në institucion u konstatua se personeli akademik dhe ai mbështetës i DFK janë pjesë e një procesi të vazhdueshëm kualifikues në fushën e kërkimit shkencor dhe përmirësimit të mëtejshëm të mësimdhënies. Rekomandohet një planifikim më i konkretizuar i aktiviteteve që lidhen direkt me trajnimet e personelit akademik, format dhe metodat e komunikimit të rezultateve të punës shkencore të studentët.
<b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Referuar dokumenteve dhe informacioneve specifike të paraqitura nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet se një pjesë e stafit të DFK është trajnuar në vazhdimësi brenda dhe jashtë vendit (Projektet Erasmus+) për përmirësimin e komunikimit akademik dhe metodave të mësimdhënies. Egziston një përvojë pozitive në organizimin e konferencave shkencore dhe konferencave vjetore studentore.
<b>Kriteri 6.</b> Personeli	Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik në DFK



<p>akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>përgjigjen për ecurinë e punës kërkimore shkencore dhe administrojnë veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore duke respektuar lirinë akademike dhe kërkimore. Konstatohet një koordinim i mirë i DFK me strukturat e tjera të UBT për të vendosur në dispozicion të grupeve mësimore një infrastrukturë bashkëkohore mbështetëse si laboratorët, kabinete të ndryshme, resurset elektronike dhe bibliotekat.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Referuar dokumenteve dhe informacioneve specifike të paraqitur nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet se DFK analizon rregullisht punën kërkimore dhe mësimore duke evidentuar arritjet, metodat e reja në mësimdhënie, përmirësimet e mundshme, etj. Rekomandohet që ky proces të evidentohet dhe dokumentohet në mënyrë më të plotë.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	


<p><b>Standardi III.5</b>  <b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Referuar RRDFK (kreu V neni 28 dhe kreu VIII, neni 55) dhe informacioneve gjatë vizitës në institucion, konstatohet se në DFK, testimi dhe vlerësimi i njohurive realizohet nëpërmjet dy rubrikave: vlerësimi i vazhduar (përfshin rezultatet e kolektiveve, detyrave të kursit, projekteve të kursit dhe angazhimin e studentëve në orën e mësimin) dhe vlerësimi në provimin përfundimtar. Mënyra e vlerësimit për çdo modul është e pasqyruar në syllabusin përkatës të modulit dhe ndodhet në website-n personal të çdo pedagogu, duke qënë publike dhe të aksesueshme nga studentët.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Referuar dokumenteve dhe informacioneve specifike të paraqitur nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet se DFK, që në orën e parë të mësimin të çdo moduli, pedagogu/titullari i lëndës njih studentët me programin e lëndës, mënyrën e vlerësimit të njohurive dhe literaturën që do të përdoret në modulën përkatës. Studentët informohen për strukturën e lëndës, përqindjet në vlerësimet, vlerësimin e vazhduar dhe përfundimtar.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e</p>	<p>Referuar dokumenteve dhe informacioneve specifike të paraqitur</p>

vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet se DFK aplikon testime e vlerësime të dijeve, njohurive e aftësive profesionale e shkencore nëpërmjet dy rubrikave: vlerësimi i vazhduar (përfshin rezultatet e kolokiumeve, detyrave të kursit, projekteve të kursit dhe angazhimin e studentëve në orën e mësimit) dhe vlerësimi në provimin përfundimtar. Nga shqyrtimi i syllabuseve konstatohet se format e vlerësimit janë të larmishme e në përputhje me objektivat e lëndës.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X


<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Referuar dokumenteve dhe informacioneve specifike të paraqitur nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet se DFK e realizon vlerësimin e studentëve të ndarë në dy pjesë: vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e modulit, si dhe vlerësimi përfundimtar. Përcaktimi i raporteve mes vlerësimit të vazhduar dhe vlerësimit përfundimtar bëhet nga cdo pedagog përgjegjës në programin e modulit dhe miratohet në fillim të çdo viti akademik nga përgjegjësi i departamentit, duke informuar studentët që në orët e para të fillimit të procesit mësimor.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Referuar dokumenteve dhe informacioneve specifike të paraqitur nga DFK (rregullorja e programit të studimit, syllabuset e lëndëve) dhe vizitës në institucion, u konstatua se DFK vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. Rekomandohet që në këtë aspekt, DFK të rrisë shkallën e informimit dhe angazhimit të studentëve dhe ta evidentojë më mirë këtë process të rëndësishëm.
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Referuar dokumenteve dhe informacioneve specifike të paraqitur nga DFK (Rregullorja e se programit të studimit, kreu V, nenet , 32, 33, 34 dhe të departamentit kreu VIII, neni 59, 60, 61, rregullorja e FEAs ) dhe vizitës në institucion, konstatohet se testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 pedagogë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit dhe pedagogu tjetër zhvillon module të ngjashme ose mund te jete pedagogu përgjegjës per pjesën e zhvillimit të seminareve. Komisioni i provimit përcaktohet nga përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me zv. Dekanin për mësimin dhe miratohet nga dekani i Fakultetit.
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të	Referuar dokumenteve dhe informacioneve specifike të paraqitur nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet se në DFK, testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim/kodifikim dhe DFK siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi. (Përdoren fletore tip me elemente sigurie, korrigjimi elektronik, egziston sistem qëndror kamerash monitorimi).

monitoruar me personel dhe mjete survejimi.									
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Referuar dokumenteve (rregullores së studimit të programit, kreu V, nenet 34 dhe 36; rregullorja e programit të studimit Bachelor, DFK), informacioneve specifike të paraqitur nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet se në DFK, vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, këshilla mbi procesin e të nxënës, sqarime mbi vlerësimin, etj.								
<b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	Referuar dokumenteve dhe informacioneve specifike të paraqitur nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet se në DFK, gjatë procesit të provimeve, njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik zbatojnë një seri rregullash që shmangin plagjiaturën, kopjimin në provime, përdorimin e celularëve, identifikimin e studentëve nëpërmjet dokumenteve të identifikimit, etj.								
<b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Referuar dokumenteve (rregullore e FEA-së, neni 65, neni 70), informacioneve specifike të paraqitur nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet se në DFK, rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.								
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Referuar dokumenteve (rregullore e FEA-së, neni 70), informacioneve specifike të paraqitur nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet se në DFK garantojnë të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Rekomandohet që të shtohet informimi i studentëve me të drejtat dhe detyrat që kanë në këtë aspekt.								
<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimi, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Referuar dokumenteve (rregullore e FEA-së, neni 73), informacioneve specifike të paraqitur nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet se në DFK, çdo kërkesë apo ankimi, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Nga bashkëbisedimi me studentet konstatohet se këto procedura janë funksionale dhe i lihet një afat kohor i caktuar studenteve për të shprehur ankimet e tyre. Këto procedura dokumentohen dhe arkivohen. Rekomandohet që ky proces dhe këto procedura të dokumentohen në mënyrë më të plotë.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td><b>Nuk përmbushet</b></td> <td><b>Përmbushet pjesërisht</b></td> <td><b>Përmbushet kryesisht</b></td> <td><b>Përmbushet plotësisht</b></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>				X
<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>						
			X						





<b>Standardi III.7</b> <b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Referuar dokumenteve, informacioneve specifike të paraqitur nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet se në DFK, programi i studimit bachelor në FK, është ndërtuar në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. Në fillim ofrohet formim i përgjithshëm bazë si modulet, mikroekonomi, makroekonomi, matematikë etj, të cilat krijojnë një bazë të qëndrueshme për thellimin e njohurive në lëndët që zhvillojnë aftësitë profesionale si, financë, kontabilitet, analizë financiare, para ja dhe bankat, taksim, investimet etj. Të gjitha këto mbështeten në dokumentin e kategorizimit të lëndëve, kurrikulën, planin mësimor.
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Në programin e studimit të DFK, rreth 52% të lëndëve të kurrikulës e zënë lëndët karakterizuese për zhvillimin e aftësisë në fushën e financës dhe kontabilitetit, të tilla si bazat e financës, bazat e kontabilitetit, kontabiliteti financiar, financat rurale etj. Ekzistojnë dhe lëndë ndërdisiplinore, që zënë 14% si prodhimin bimor, prodhimin shtazor. Gjithashtu, zhvillohen lëndë plotësuese si gjuha e huaj anglisht dhe informatikë. Rekomandohet që të shihet mundësia e zgjerimit të njohurive informatike, komunikimit dhe teknologjisë së informacionit.
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Referuar dokumenteve (proçedura për ndryshimin e kurrikulës si dhe kurrikulës aktuale të programit Bachelor FK, 2018-2019), informacioneve specifike të paraqitur nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet se në DFK ka përdorur forma të syllabusit, ku një nga rubrikat paraqet objektivat e modulit përkatës. Objektivat e modulit pasqyrohen në syllabuset sipas VKM nr. 41 për secilin modul të programit të studimit në rubrikën përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit. DFK dhe grupet mësimore kërkimore diskutojnë dhe analizojnë për njohuritë e përftuara në secilën lëndë, për strukturën e tyre sipas semestrave, kursin e zhvillimit të këtyre lëndëve. Rekomandohet që ky proces të zhvillohet dhe dokumentohet më gjerësisht.
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Referuar dokumenteve (rregullores së programit Bachelor, Financë Kontabilitet, kreu II, neni 14, pika 7, 8, 9, 10.), informacioneve specifike të paraqitur nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet se në DFK para përfundimit të procesit mësimor, pedagogët e çdo moduli, komunikojnë me studentët për konkluzionet dhe i orientojnë ata për tezën përfundimtare.
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit	Referuar dokumenteve, informacioneve specifike të paraqitur nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet se në planin e aktiviteteve të DFK-së pasqyrohet zhvillimi i leksione të hapura nga personalitete të ftuara të fushës të cilët ndikojnë duke ju ofruar studentëve zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukture së programit të studimit, pasi studentët do të




të studimit.	jenë më të mirëformuar. Rekomandohet që kjo eksperiencë të zgjerohet akoma më tej në shtrirjen dhe periodicitetin e saj në shumicën dërrmuese të lëndëve që zhvillohen në bachelor FK.			
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Referuar dokumenteve, informacioneve specifike të paraqitur nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet se një pjesë e madhe e pedagogëve të DFK, kanë përgatitje dhe formimin shkencor dhe profesional për të ndihmuar studentët të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Disa pedagogë të DFK kanë qenë anëtarë të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, anëtarë të Bordit të Bankës së Shqipërisë dhe anëtarë e drejtues në shoqatën e SHKFSH, eksperiencë kjo, e vënë në mënyrë eficiente në shërbim të studentëve.			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Referuar dokumenteve, informacioneve specifike të paraqitur nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet anëtarët e DFK i diskutojnë çështjet që lidhen me programin e studimit Financë Kontabilitet, në nivel GMK, në nivel departamenti, në nivel Fakulteti dhe sektorin e IT. Rekomandohet që ky proces të planifikohet dhe dokumentohet më mirë në dokumentacionin e DFK.			
<b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Referuar dokumenteve, informacioneve specifike të paraqitur nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet se personeli akademik i DFK është i angazhuar për krijimin e një klime të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve. Rekomandohet që ky proces të jetë më i konkretizuar në dokumentacion dhe indikatorë të qartë që masin dhe reflektojnë realizimin në praktikë të tij.			
<b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	Referuar dokumenteve, informacioneve specifike të paraqitur nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet se studentët e vitit të fundit Bachelor FK marrin pjesë në kërkim nëpërmjet diplomave që realizojnë. Kërkimet më të vlerësuara prezantohen në konferenca të organizuara nga UBT/FEA/DFK, në konferenca të organizuara nga shoqata studentore. Një element shumë i veçantë është klasifikimi JEL. Studentët duhet të klasifikojnë punimin e tyre sipas metodologjisë JEL, që është edhe klasifikimi ndërkombëtar i kërkimeve akademike. Rekomandohet që DFK, brenda mundësive financiare dhe hapësirës ligjore të bëjë më shumë për mbështetjen financiare të studentëve.			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Një pjesë e stafit të departamentit FK përveç diskutimeve brenda GMKve përkatëse lidhur me metodat e mësimdhënies, janë trajnuar dhe jashtë vendit për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimin e metodave të reja. Rekomandohet që DFK ti kushtojë një vëmendje më të madhe problemit të mobilitetit të studentëve.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	



<b>Standardi III.8</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Referuar dokumenteve (rregullores së programit të studimit Bachelor, kreu V, nenet 32, 33, 34, 35, 36), informacioneve specifike të paraqitur nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet se DFK u bën të njohur studentëve të vitit të fundit programin e provimit të formimit nëpërmjet sekretarisë mësimore dhe asaj te departamentit dhe informon studentët rreth organizimit të provimeve të formimit. DFK, brenda muajit të parë të semestrit të pestë, në bazë të mundësive të tyre për udhëheqje dhe në përputhje me natyrën e fushës së studimit, listojnë studentët që planifikohen të diplomohen nëpërmjet mbrojtjes me punim diplome, ku përfshihen studentë që gjatë dy viteve të para të studimeve kanë arritur rezultate të larta sipas specifikimeve të vendosura në departament.
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Në bazë të metodologjisë dhe dokumentacionit të miratuar në DFK, pedagogët udhëheqës në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës asistojnë studentët që kanë nën udhëheqje për shkruarjen e temës së diplomës. Studentëve të vitit të tretë që në fund të semestrit të 5 ju vendoset në dispozicion një listë me pyetje/ushtrime nga lëndët të profilit ku ka midis tyre module kryesisht të fushës së financës dhe kontabilitetit.
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Referuar dokumenteve (lista orientuese për temat e diplomave), informacioneve specifike të paraqitur nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet se në DFK, studentëve të vitit të tretë në fund të semestrit të pestë ju vendoset në dispozicion një listë me pyetje/ushtrime nga lëndët e profilit ku ka midis tyre module të bazave të financës, investimet, tregjet dhe institucionet financiare, paraja dhe bankat, kontabilitetit financiar, kontabiliteti i drejtimit, i koston, publik dhe analiza financiare. Kjo listë me pyetje/ushtrime gjendet në bibliotekë në hard copy. Në provimin e formimit tezat hartohen duke gërshetuar ushtrimet dhe pyetjet nga modulet e profileve formim i përgjithshëm dhe ai profesional.
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	Referuar dokumenteve, informacioneve specifike të paraqitur nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet se brenda një muaji nga dita e fillimit të vitit akademik, departamenti, nëpërmjet sekretarisë mësimore dhe asaj te departamentit, u bën të njohur studentëve të vitit të fundit programet e provimit të formimit dhe informon studentët rreth organizimit të provimeve apo temave të diplomës.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Në rastin e punimit të diplomës në programin Financë Kontabilitet, studentët asistohen duke ju vendosur në dispozicion laboratorin me kompjutera. Studentët mund të shfrytëzojnë kompjuterat dhe programet e instaluar, mund të navigojnë në internet ku mund të shkarkohen software pa pagesë.



<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Referuar rregullores së departamentit, informacioneve specifike të paraqitur nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet se pedagogët udhëheqës të diplomave asistojnë studentët që kanë nën udhëheqje për shkruarjen e temës së diplomës duke i ndihmuar ata me materiale, me ndarjen në çështje dhe nën çështje, me metodat dhe metodologjinë e kërkimit, etj., në përputhje me udhëzuesit e miratuar.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Referuar rregullores së departamentit, informacioneve specifike të paraqitur nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet se në përfundim të studimeve të ciklit të parë Bachelor në Financë Kontabilitet, studenti dorëzon kopjen e punimit të diplomës e miratuar nga udhëheqësi shkencor. Mbrojtja e diplomës bëhet përpara një komisioni me pesë anëtarë të propozuar nga departamenti dhe miratuar nga dekanati. Mbrojtja bëhet me gojë dhe vlerësimi final i studentëve bëhet me notë.</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Referuar rregullores së departamentit, informacioneve specifike modeli i diplomës, modeli i Suplementit të Diplomës) të paraqitur nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet se në përfundim të studimeve në cikline parë të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës.</p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të zhvilluar.</p>	<p>Në DFK, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, në rastet kur ai e kërkon këtë gjë. Studentët depozitojnë pranë ZSS (Zyra e Studimit dhe Studentëve) një kërkesë dhe brenda një afati të caktuar u jepet një kopje e firmosur dhe vulosur e programit të ciklit të studimit Bachelor.</p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Referuar rregullores (rregullorja e sekretarisë, inkorporuar në rregulloren e DZHKKVI), informacioneve specifike të paraqitur nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet se dokumentacioni për studentët ruhet nga UBT për një periudhë të pacaktuar në hard kopje (regjistrat e mëdhenj të studentëve) si dhe në databazën digjitale që tashmë disponon UBT.</p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				X

<p><b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III</b></p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				X




**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA  
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Referuar Rregullores së Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Pagave të Universitetit Bujqësor të Tiranës, formatit të dosjes personale të stafit, si edhe verifikimit në Institucion, konstatohet se institucioni mbledh dhe ruan të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit.</p> <p>Por, nisur nga dy raste që u verifikuan posaçërisht, konstatohet se çalon puna në drejtim të rregullit dhe përditësimit të të dhënave.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Konstatohet se egziston “Rregullorja për Rekrutimin e Stafit Akademik, Ndihmës dhe Administrativ” si edhe dokumentacioni i nevojshëm për rekrutimin e personelit.</p> <p>Nisur nga dy rastet që u verifikuan posaçërisht, vlerësojmë se procedurat ishin funksionale dhe të bazuara në rregullore.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kriterëve të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Referuar formatit të publikimit të kriterëve dhe dokumentit me titull “Rregullorja për Rekrutimin e Stafit Akademik, Ndihmës dhe Administrativ”, konstatohet se IAL ka hartuar procedura dhe se kriteret e përgjithshme e të veçanta për rekrutimin e personelit bëhen publike në momentin e shpalljes së vendit vakant të punës.</p> <p>Konkretisht për një vend vakant pune, departamenti përcakton kriteret e nevojshme dhe më pas merr miratimin e rektorit.</p> <p>Gjatë verifikimit në vend konstatohet se procedurat dhe publikimi i kriterëve ishin funksionale.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret e përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të</p>	<p>Konstatohet se procedurat e rekrutimit mbajnë parasysh kriteret e përgjithshme të përcaktuara në rregulloren e drejtorisë së burimeve njerëzore.</p> <p>Konstatohet gjithashtu se është departamenti Financë Kontabilitet që përcakton kërkesat specifike të vendit të punës dhe më tej UBT ndjek procedurën e rekrutimit të personelit.</p> <p>Vlerësojmë se gjithshka nis nga departamenti dhe kjo garanton përzgjedhjen e personelit në nivelin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e programit.</p> <p>Konstatohet se “Rregullorja për Rekrutimin e Stafit Akademik, Ndihmës dhe Administrativ”, ka të përsaktuar procedurat që</p>

studimit.	ndiqen për rekrutimin, që nga njoftimi deri në përfundim të procedurës së përzgjedhjes dhe pranimit, ankimimit, nxjerrja e aktit të emërimit. Nga verifikimi në vend vlerësojmë se këto procedura zbatohen gjë që garanton se personeli përzgjidhet sipas kritereve të përgjithshme dhe ato specifike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efëcente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Nga verifikimi gjatë vizitës në Institucion konstatohet se Njësia kryesore ka dy ndërtesa me salla të pajisura leksionesh e seminaresh në gjendje të mirë. Konstatohet se pedagogët janë sistemuar në zyra të pajisura e në gjendje të mirë. Ka dy biblioteka, ajo e UBT-së e pajisur mirë si edhe ajo funksionale online e Njesisë kryesore (Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Konstatohet se Departamenti Financë Kontabilitet ka një personel të kualifikuar mirë që bën përpjekje për kualifikim të mëtejshëm nga pikëpamja akademike dhe e kërkimit shkencor. Këto përpjekje, vlerësojmë se, mbështeten mirë nga njësia kryesore dhe ajo bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmes krijimit të kushteve të mira të punës, pajisjes me literaturën bashkohore dhe metodat e reja të mësimdhënies si dhe marrëveshjeve me qëllim kualifikues me institucione të huaja. Vlerësojmë se më shumë duhet bërë për klasifikimin e revistave ku publikohet dhe për bazën e vlerësimit të atyre me faktor impakti. Konstatohet se ka publikime të vitit 2018 në revista me faktor impakti nga personel me gradën Doktor por jo nga personel me gradën Prof. Vlerësojmë, gjithashtu, se më shumë duhet bërë për financimin e aktiviteteve kualifikuese.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Nga verifikimi përmes vizitës, konstatohet se Institucioni ka krijuar mundësi për metoda të reja të mësimdhënies përmes përdorimit të teknologjive të reja. Konstatohet se janë përdorur metoda lehtësuese si E-learning dhe ajo e bazuar në aplikimet e Google, si edhe aksesit në literaturë përmes bibliotekës online të Njesisë kryesore dhe përmes Modullit online “Njohuria mbi informacion”.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e	Nga verifikimi në Institucion si edhe referuar dokumentit me titull “Plani i Ngarkesës Mësimore_2018-2019” për Departamentin Financë Kontabilitet, si edhe Rregullores së Departamentit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, konstatohet se përgjegjësitë

objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	dhe ngarkesat më të mëdha i takojnë personelit me kualifikim më të lartë akademik e kërkimor. Nga ana tjetër konstatojmë mbingarkesë mësimore për një pjesë të konsiderueshme të personelit akademik me kohë të plotë. Institucioni duhet të marrë masa për rekrutimin e personelit të ri.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Nga vizita në Institucion konstatojmë se veprimtaria mësimdhënëse teorike e programit të studimit Financë Kontabilitet zhvillohet në ndërtesën A me 2 kate dhe në atë B me katër kate. Gjithsej janë 15 salla leksionesh, 37 seminaresh dhe 4 laboratorë. Sallat e leksioneve janë të pajisura me videoprojektorë. Institucioni kryesor ka dy biblioteka të pajisura mirë dhe funksionale. Nga vizita në ambiente vlerësojmë se gjendja ishte e mirë, por më shumë ndriçim duhet të ketë tek ndërtesa A si edhe ambientet ndihmëse si banjo duhen rikonstruktuar.
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Nga vizita në Institucion, konstatojmë se sallat e leksioneve janë të pajisura me videoprojektorë dhe pedagogët janë të pajisur me laptop.
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Nga vizita në Institucion, konstatojmë se laboratorët e teknologjisë së informacionit janë të pajisur me pajisje dhe kompjutera funksionalë për zhvillimin e oreve laboratorike.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron	Nga vizita në Institucion, konstatojmë se Njësia kryesore



së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	(Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit) ka në dispozicion 4 laboratorë të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale funksionale			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Konstatohet se Institucioni ka lidhur marrëveshje funksionale me subjekte private për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve. Pjesa më e madhe e praktikës zhvillohet në ambientet e subjekteve private, që vlerësojmë se janë të përshtatshme për zhvillimin e praktikave të studentëve. Veprimtari të tjera praktike zhvillohen në laboratorët e Njesisë kryesore, që janë të mjaftueshme e të përshtatshme.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Konstatohet se janë funksionale dy biblioteka në mjediset e Institucionit, ajo e Universitetit Bujqësor të Tiranës, e pajisur mirë me literaturë bashkohore, si edhe ajo funksionale <i>online</i> e Njesisë kryesore (Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit). Vlerësojmë se studentëve të programit të studimit u garantohej mundësia e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë e literaturës së ofruar nga bibliotekat në fjalë.
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Referuar dokumentit me titull “Universiteti Bujqësor i Tiranës, Biblioteka Shkencore "Mentor Përmeti", si edhe verifikimit në Institucion, konstatohet se Biblioteka e Universitetit Bujqësor të Tiranës është e pajisur mirë me literaturë fizike që përfshin tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, në gjuhë shqipe dhe të huaj. Vlerësojmë se kjo literaturë i mbulon mirë lëndët dhe modulet e programit të studimit Financë Kontabilitet.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të	Nga vizita në Institucion, konstatohet se Biblioteka e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit ofron kushte të barabarta përdorimi




barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	online dhe pa pagesë për studentët që konsultojnë literaturën specifike të fushës së programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet.			
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Konstatohet se Biblioteka e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit ka një kapacitet prej 100 vendesh, 10 kompjutera, akses interneti dhe pajisje të tjera teknike. Vlerësojmë se studentët përdorues nuk përballen me kufizime të rëndësishme.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Referuar dokumentit me titull “Plani Strategjik i Bibliotekës Shkencore Mentor Përmeti”, vlerësojmë se më shumë duhet detajuar plani për shtimin e zërave të bibliotekës dhe përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit të studimit Financë Kontabilitet.			
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Nga vizita në Insitucion GVJ konstaton se për të 2 bibliotekat funksionale nuk ka kufizime të rëndësishme në lidhje me numrin e përdoruesve të njëkohshëm apo në lidhje me orarin e përdorimit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**Standardi IV.5**

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Konstatohet se Institucioni ka ngarkuar Zyrën e Studimeve dhe Studentëve me detyrën e administrimit të informacionit të lidhur me studentët. Zyra në fjalë disponon dokumenta fizikë si edhe sistemin <i>Esse3</i> për administrimin elektronik të të gjithë informacionit të lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi, transferime të mundshme dhe deri në diplomim në programin e studimit. Nga verifikimi në praktikë i disa rasteve, vlerësojmë se dokumentacioni fizik dhe sistemi elektronik <i>Esse3</i> funksionojnë në rregull.
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe	Referuar dokumentit me titull “Rregullore mbi Organizimin dhe Funksionimin e Degës së Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Zhvillimit Institucional”, si edhe nga komunikimi në Institucion, konstatohet se administrimi i informacionit, dokumentacionit dhe



aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	aktivitetit të personelit realizohet nga Dega e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional (DZHKKVI). Kjo degë është pjesë përbërëse e strukturës organizative të IAL-it dhe funksionon si njësi ndihmëse e rektoratit dhe mban lidhje të drejtpërdrejta me dekanët e fakulteteve. Nga vizita në institucion konstatojmë se dega në fjalë e mbështet aktivitetin e saj në Sistemin elektronik Esse3, përmes përdorimit të të cilit kryen monitorime, raportime, komunikime, etj.			
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Nga vizita në Institucion dhe nga rastet e verifikuara, vlerësojmë se sistemi i menaxhimit siguron akses në informacione e dokumente për personelin dhe studentët e programit të studimit përmes llogarive të sistemit Esse 3 si edhe përmes website-s zyrtare <a href="http://ubt.edu.al/">http://ubt.edu.al/</a> .			
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Nga verifikimet e kryera gjatë vizitës në Institucion konstatojmë se në sistemin e Esse3 ka llogari individuale të çdo pedagogu ( <a href="https://www.ubt.esse3.u-gov.rash.al/Home.do">https://www.ubt.esse3.u-gov.rash.al/Home.do</a> ), që shërbejnë për komunikimin mes pedagogëve, studentëve dhe personelit administrativ. Komunikimi bazohet edhe tek regjistrimi në sistem i adresave elektronike të studentëve dhe numrave të tyre të telefonit.			
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Nga vizita dhe verifikimi praktik në Institucion, konstatojmë se sistemi i menaxhimit Esse 3 funksionon mirë duke bërë të mundur monitorimin dhe raportimin e shpejtë të aktivitetit dhe respektimin e afateve të plotësisimit të detyrave.			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Nga verifikimi praktik GVJ, konstaton se është funksionale, në shqip dhe anglisht, faqja zyrtare e Institucionit me informacione që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi IV.6**

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV, konstatohet se raporti financiar i kostove si edhe plani për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit hartohet për një cikël të plotë studimi. Ky plan miratohet nga senati i universitetit dhe bordi i administrimit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Konstatohet se plani i financimit të programit të studimit mbështetet në rreth 60% nga granti i buxhetit të shtetit dhe pjesa tjetër nga pagesat e studentëve për arsimim, të ardhurat për shërbimet e kryera, të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta, donacione dhe burime të tjera financimi nga veprimtari kërkimore-shkencore.</p> <p>Konstatohet, gjithashtu, se plani i financimit të programit të studimit përmban financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara, kontratat e shërbimeve dhe zëra të tjerë specifikë.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Nga vizita në terren dhe mbi bazën e dokumentacionit, konstatohet se Institucioni kryen çdo vit auditim të brendshëm dhe të jashtëm. Procesi i auditimit të brendshëm kryhet nga Njesia e Auditimit të Brendshëm. Ky aktivitet rregullohet nga “Rregullorja e Auditimit të Brendshëm”. Konstatohet se egziston plani vjetor i auditimit i aprovuar nga bordi i administrimit si edhe raportimi vjetor tek ky bord. Konstatohet se Raporti financiar e përmban pasqyrën financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët si edhe ndarjen e burimeve financiare.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të</p>	<p>Referuar dokumentit të titulluar “Plani i Financimit”, si edhe atij me titull “Plani Strategjik i Ciklit të Parë për Programin Financë Kontabilitet: 2016-2025”, si edhe nga vizita në Institucion, konstatohet se në mbyllje të çdo cikli studimi dokumentohen raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike. Konstatohet se planifikimi i ndërhyrjeve të posaçme dhe diversifikimi eventual të financimit të programit nuk detajohet sa duhet.</p>



programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.				
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Konstatohet se financimi i institucionit realizohet në masën mbi 60 % nga buxheti i shtetit dhe për pjesën tjetër nga të ardhurat e vetë institucionit. Vlerësojmë se financimi buxhetor dhe kapacitetet e vetë institucionit e garantojnë qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X



## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Referuar rregullores (plani strategjik i UBTsë dhe dokumentit nr. 50, të dhëna të planit të financimit), informacioneve specifike të paraqitura nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet se UBT harton një raport financiar të kostove mesatare të programit të studimit. Financimi për studentet bëhet nga granti i shtetit në bazë të ligjit të Arsimit të lartë 2015. Financimi i grantit është miratuar nga UBT dhe bëhet nga Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë. Llogaritet nga buxheti i shteti me formulë, për programin Bachelor të të gjitha fakulteteve, pra granti i shtetit pjesëtuar me numrin e studentëve, sipas vendimi nr. 75, date 12.2.2018. UBT harton plan buxhetor afat mesëm, pjesë e planit strategjik të zhvillimit të institucionit. Plani buxhetor hartohet çdo vit dhe miratohet nga senati i universitetit dhe bordi i administrimit. Ky plan përfshin koston e programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të	UBT ka hartuar një plan strategjik të universitetit për periudhën 2016-2025, në të cilin parashikon planin strategjik për zhvillimin e programit në nivel akademik, financiar, burimesh njerëzore. Plani i


Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij. Ky plan, megjithë nevojën për përmirësime të mëtejshme të disa prej treguesve e procedurave të tij, garanton barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.
<b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Referuar rregulloreve përkatëse, informacioneve specifike të paraqitur nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet se kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë të qarta, të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Referuar rregulloreve përkatëse, informacioneve specifike të paraqitur nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet se DFK dhe UBT harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve. Rekomandohet që këto dokumenta e kriteret të jenë më të aksesueshme nga të gjithë dhe të komunikohen në mënyrë më eficiente për publikun.
<b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Në përputhje me informacionin e raportit financiar vjetor institucional rezulton se financimi i institucionit realizohet në masën mbi 60 % nga qeveria dhe mbi 30% nga të ardhurat e universitetit. Qeveria jep grantin e mësimdhënies, paguan pagat e personelit, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, bursat e studentëve dhe grantin për investime. Të ardhurat e universitetit sigurohen nga tarifat dhe shërbimet për studentët, nga projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, nga qendra eksperimentale, EDEA, nga qeraja e ambjenteve etj. UBT garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit. Nuk ka dokumentacion specifik që parashikon regjistrimin e studentëve të huaj. Rekomandohet që DFK të hartojë dhe të zbatojë një plan veprimi specifik dedikuar regjistrimit të studentëve të huaj.
<b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të	Referuar rregulloreve përkatëse, informacioneve specifike të paraqitur nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet se DFK dhe UBT harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve. Rekomandohet që këto dokumenta e kriteret të jenë më të aksesueshme nga të gjithë dhe të komunikohen në




veçanta të programit të studimit.	mënyrë më eficiente për publikun.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Referuar rregulloreve përkatëse (rregulloren e departamentit Financë-Kontabilitet (RRDFK), neni 3, pika b, neni 5, pika a, neni 6, germa b, neni 7, pikat 6, 14, 15 dhe neni 9, germa A, pika 5, germa B, pika 7), informacioneve specifike të paraqitur nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet se DFK vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Sipas RRDFK, neni 3, germa f, DFK përzgjedh studentët fitues, mbështetur në rezultatet e nxënësve në studimet e tyre në shkollën e mesme si dhe Maturën Shtetërore. Lista miratohet nga përgjegjësi i departamentit, dhe i përcillet Qendrës së Shërbimeve Arsimore. Në dobi të transparencës, lista e fituesve shpallet në faqen web të universitetit. Në fillim të vitit akademik, DFK informon studentët mbi programin e studimeve, shpërndan guidën “udhëzuesin për studentët” dhe një fletëpalosje me informacione të detajuara.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Referuar guide-s me titull “Udhëzime për Studentët” si edhe nga komunikimi në Institucion, konstatohet se studentët marrin informacion të plotë për vlerësimin e tyre, format e kontrollit të dijeve dhe ankesat për vlerësimin. Konstatohet se ka angazhim nga personeli i departamentit për përcjelljen e informacionit përmes faqeve web që aksesohen lehtësisht nga studentët. Konstatohet se kriteret dhe procedurat janë parashtruar edhe në rregulloren e brendshme të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit, e cila është e publikuar në web faqen e universitetit.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Konstatohet se çdo fillim viti, përgjegjësi i departamentit zhvillon takime të hapura me studentët e vitit të tretë në lidhje me temën e diplomës. Studentët informohen mbi aplikimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e diplomës. Konstatohet se informacioni gjendet në guide-n “Udhëzime për Studentët”, në web faqet e personelit akademik si edhe në web faqen e IAL-it.
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon	Nxitja e nxënësve kandidat për studentë për të studiuar në këtë program studimi bëhet përmes një fushate informimi në shkollat e mesme (profesionale dhe të përgjithshme), e cila realizohet nga Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA) në universitet. Staf i

udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	departamentit realizon artikuj në shtypin periodik, portale të ndryshme dhe dalje televizive për të informuar studentët kandidat mbi programin e studimit në FK.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Referuar rregulloren e DFK (Rregullorja e DFK, , nenet 7,14, 18, 21,22 dhe 23; Guida “Udhëzimi për studentët”) , informacioneve specifike (faqja e internetit e FEA; aktiviteti Zyrës së Karrierës) të paraqitur nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet se DFK angazhohet rregullisht në informimin në mënyrë të hollësishme për strukturat, organizimin dhe kohëzgjatjen e programeve të studimit. Përgjegjësi i departamentit zhvillon takime të hapura për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Konstatohet se një informacion i plotë jepet në guide-n “Udhëzim për studentët”, në faqen web të IAL-it, në Rregulloren e departamentit FK dhe në web faqet e personelit akademik. Konstatohet se profili personal i studentit në sistemin elektronik (platforma Esse3), përmban informacion të plotë mbi modulet; lëndët; objektivat e veprimtarisë; kushtet paraprake; përshkrimin e shkurtër të programit të lëndës; formën e mësimit; detyrimet e studentit dhe mënyrën e vlerësimit.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Referuar rregulloren e DFK (Rregullorja e DFK, neni 20, pika 4, 7,9, 10, 11 dhe 12), informacioneve specifike (organizimi i panairit të karrierës; dokumenti i skedës së punësimit) të paraqitur nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet se DFK informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Konstatohet se studentët informohen mbi zhvillimin e organizimin e procesit mësimor në sistemin elektronik (platforma Esse3), në web faqet e personelit akademik, në mjediset e fakultetit si edhe në sallat e leksioneve e seminareve.
<b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e	Referuar rregulloren e DFK (neni 23, 59, 66), informacioneve specifike (profilet personale të studentëve në sistemin elektronik/platforma



studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	ESSE3; faqet personale në web të pedagogëve; guida dhe udhëzime specifike nga stafi IT) të paraqitur nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet se në DFK dhe FEA, konstatojmë se në profilin personal të studentit në sistemin elektronik (platforma Esse3) jepet informacioni mbi modulet, lëndët, objektivat e programit, kushtet paraprake, formën e mësimit, detyrimet e studentit dhe mënyrën e vlerësimit. Studenti ka lehtësisht akses në distancë në profilin e tij personal.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Vlerësohet se përdorimi i sistemit/platformës elektronike ESSE3, puna e Zyrës së Informacionit dhe Statistikës, etj, dëshmojnë se DFK dhe FEA disponojnë dhe mbajnë statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi. Referuar DVV, për vitin akademik 2017-2018 janë diplomuar 126 studentë të ciklit të parë. Aktualisht në programin e studimit Bachelor FK studiojnë 457 studentë.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Referuar rregullores se DFK si dhe gjatë vizitave në Institucion GVJ verifikoi dhe konstatoi se statistika të tilla disponohen dhe regjistrohen me përpikmëri.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	Gjatë vizitës në institucion u konstatua se, mbështetur në rregulloren mbi organizimin dhe funksionimin e Degës së Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional, struktura drejtuese e UBT, Zyra e Informacionit dhe Statistikës në bashkëpunim me ZSS-në, grumbullon dhe përpunon të dhënat statistikore për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. Keto të dhëna janë të klasifikuara sipas viteve të studimit dhe të ndara edhe sipas mesatareve të pranimit të studentëve. Referuar dokumentit “Të dhëna për regjistrimin e studentëve për ciklin e studimeve Bachelor, grupuar sipas mesatareve për Vitet Akademike 2018-2019; 2017-2018; 2016-2017; 2015-2016; 2014-2015” konkretisht për vitin akademik 2018-2019 vihet re pranimi i studentëve me



	një mesatare mbi 8.			
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Gjatë vizitës në institucion u konstatua se në DFK (FEA dhe UBT), të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit. Ato janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Këto të dhëna janë të disponueshme në këtë system (ESSE3), si edhe administrohen nga vetëm nga persona të autorizuar të ZSS.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Gjatë vizitës në institucion u konstatua se, mbështetur në rregulloren mbi organizimin dhe funksionimin e Degës së Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional, struktura drejtuese e UBT, Zyra e Informacionit dhe Statistikës në bashkëpunim me ZSS-në, hartojnë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke i shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Rekomandohet që DFK të angazhohet më shumë në organizimin dhe bashkëpunimin me të diplomuarit e punësuar në një periudhë 5 ose 10 vjecare (Alumni-t) për të vlerësuar më saktë ecurinë dhe strukturën e punësimit të tyre.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**Standardi V.5**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Referuar rregullores së DFK, informacioneve specifike të paraqitur nga DFK dhe vizitës në institucion, konstatohet se Statuti i universitetit sanksionon në nenin 5, që, studentët janë pjesë e strukturave drejtuese të UBT. Tre nga 25 anëtarë të senatit janë student të zgjedhur po nga studentët. Studentët kanë nga një përfaqësues në komisionet e përhershme: Komisioni i Sigurimit të Cilësisë, Komisioni i etikës, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor, si në nivelin e universitetit ashtu edhe në nivel të fakulteteve. Studentët kanë të drejtë të organizohen në këshilla studentore në nivel fakulteti dhe universiteti.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të	Vlerësohet se DFK (FEA dhe UBT) në përputhje me ligjin nr. 80/2015, në statutin e UBT, neni 64, shprehet se studentët kanë të drejtë të zgjedhin dhe të zgjidhen si përfaqësues në organet vendimmarrëse të universitetit në senat dhe komisionet e përhershme. Në pajtim me, nenin 64 sanksion që për sigurimin e cilësisë dhe në respekt të ligjit nr. 80/2015, neni 103, pikat 2, 3 dhe 4, DFK organizon vlerësimin e brendshëm të procesit mësimor dhe të kontrollit të dijeve nga studentët nëpërmjet anketimit në fund të çdo semestri.

verifikueshme e të matshme.									
<b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Nga komunikimi me studentët dhe personelin akademik, vlerësojmë se përmirësimi i programit të studimit merr parasysh mendimet e shprehura nga studentët në anketimet e mëparshme. Nga verifikimi i kryer, konstatojmë edhe se njihen studimet e kryera më parë.								
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Vlerësohet se DFK (në përputhje me Statutin e UBT, neni 64) garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to. Këshillat e Studentëve shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet e organizimit dhe funksionimit të DFK.								
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Në orët e fundit të mësimin të semestrit, pedagogu u komunikon studentëve në sallat e mësimin nëse ata kanë shlyer detyrimet (pjesëmarrja në mësim dhe elementët e tjerë të vlerësimit gjatë semestrit) për t'u futur në provimin final apo jo. Referuar rregulloreve dhe komunikimit me studentët, konstatojmë se studenti e gëzon realisht të drejtën e ankimimit për rezultatet. Ankesat bëhen me shkrim, i drejtohen dekanit dhe marrin përgjigje mbas verifikimeve të kryera. Konstatojmë se, përmes anketimit, studentët japin mendim mbi procesin e vlerësimit të çdo lënde në fund të çdo semestri. Anketa është anonime dhe studentët kanë akses në rezultate.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						


**Standardi V.6**

**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet	Konstatojmë se studentëve u shërbehet në drejtim të mësimin dhe zhvillimit të karrierës. ZSS ofron informacion për regjistrimin, drejtimet e diplomimit, plotësimin dhe dorëzimin e diplomave, transferimin nga një fakultet në tjetrin, zhvillimin e procesit mësimor, pagesën e tarifës së studimeve, etj. Zyrat e QKA-së, të

ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	ngritura pranë çdo fakulteti, ofrojnë shërbime të lidhura me karrierën.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Vlerësohet se DFK disponon procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit, këshillimit e shërbimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. (rregulloren mbi organizimin dhe funksionimin e Degës së Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional, neni 16, 41; ZSS; QKA).			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Konstatohet se zyrat e QKA-së janë të ngritura pranë çdo fakulteti dhe ofrojnë shërbime të lidhura me karrierën. Konstatohet se studentët marrin informacione rreth mundësive të praktikave profesionale, praktikave mësimore, punësimit, internshipe, studime jashtë vendit, shkëmbime me universitetet partnere të UBT_së, etj. Këshillimet dhe ndihma në zhvillimin e karrierës përfshijnë CV-të, përgatitje për pjesëmarrje në Panairët e karrierës, ndërmjetësime për punësim dhe internship.			
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Vlerësohet se DFK në bashkëpunim me QKA, e vë në dispozicion të studentëve që kanë përfunduar studimet në tregun e punës. Mbështetur në rregulloren mbi organizimin dhe funksionimin e Degës së Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional, neni 41, e vë në dispozicion të studentëve tre aspekte: profilin e studentit; vlefshmërinë e diplomës për tregun e punës; aftësitë që ofrojnë programet e studimeve; punësimin e tyre. E vë në dispozicion të studentëve dhe strukturave drejtuese të UBT.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X



## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR



<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>UBT i kushton vëmendje sigurimit të brendshëm të cilësisë. Pranë UBT funksionon, Dega e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional. Pjesë e strukturës së kësaj dege është zyra e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit institucional (ZSCVI). Ajo është pjesë organike e strukturave të vlerësimit të cilësisë. Pranë UBT organizohen dhe funksionojnë Komisionet e Përhershme si: Komisioni i Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor. Këto komisione janë të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel fakulteti. ZSCVI merret me respektimin e standardeve për hartimin e dokumentacionit që rregullon realizimin e procesit mësimor në nivel universiteti. Ajo kujdeset që dokumentacioni që prodhohet në fakultetet të përputhet me standardet kombëtare të cilësisë sipas cikleve të studimit</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Referuar rregulloreve përkatëse, informacioneve specifike të paraqitur dhe vizitës në institucion, konstatohet se UBT dhe fakultetet kanë të ngritur dhe bërë funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbatojnë një strategji të qartë institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. Kjo shprehet në rregulloret e veprimtarisë së UBT, rregulloren e DZHKKVI, kreu VI.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Vlerësohet se UBT i është nënshtruar akreditimit institucional dhe ka qënë pjesë e grupit të parë të IAL që hynë në process akreditimi të programeve. Rezulton se UBT përmbushi plotësisht tre kriteret dhe kryesisht dy prej tyre. UBT është akredituar institucionalisht për katër vite nga bordi i akreditimit të AL, bazuar në vendimin e akreditimit 2016.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit</p>	<p>Referuar rregulloreve dhe dokumentacionit përkatës, informacioneve specifike të paraqitur dhe vizitës në institucion, konstatohet se UBT ka reflektuar drejt mbi çdo rekomandim të bërë nga GVJ gjatë akreditimit institucional. UBT kryen periodikisht vlerësimin e cilësisë në çdo Fakultet e Departament të saj (përfshirë këtu dhe DFK) duke qënë e fokusuar në drejtim të sigurimit të cilësisë.</p>

të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngrë njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	Referuar rregulloreve dhe dokumentacionit përkatës, informacioneve specifike të paraqitur dhe vizitës në institucion, konstatohet se pjesë e strukturave të rektoratit të UBT është edhe DZHKKVI, e rregulluar me vendim senati dhe sanksionuar në statutin e UBT. DZHKKVI mbikëqyr dhe kontrollon të gjithë procesin e kurrikulave si dhe atë të mësimin në UBT dhe të gjitha njësitë e saj.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita ne Institucion GVJ u njoh me evidenca te mekanizmave dhe proceseve të tilla. Vlerësojmë se procesi i dokumentimi duhet të jetë më sistematik dhe më i plotë.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Referuar rregulloreve dhe dokumentacionit përkatës, informacioneve specifike të paraqitur dhe vizitës në institucion, konstatohet se UBT përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve. Bazuar nërregulloren e DZHKKVI dhe procesit të zgjedhjes dhe funksionimit të komisioneve të përhershme, ato janë të shprehura në dokumentet strategjike dhe rregullative të UBT edhe Fakulteteve përkatëse të saj.
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Nga takimet ne Institucion dhe nga shqyrtimi DVV, GVJ konstaton se rezultatet e vlerësimeve i bëhen të njohura DFK-së dhe FEA-s.
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra	Referuar rregulloreve dhe dokumentacionit përkatës, informacioneve specifike të paraqitur dhe vizitës në institucion, konstatohet se DFK, FEA dhe UBT hartojnë raporte vjetore të performancës së stafit dhe veprimtarisë në çdo komponent të saj,



për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	mësimor, kërkimor apo administrativ dhe financiar duke marrë masa për përmirësimin e mangësive dhe adresimin e problemeve.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Referuar rregulloreve dhe dokumentacionit përkatës, informacioneve specifike të paraqitur dhe vizitës në institucion, konstatohet vlerësimi i brendshëm i programit të studimit, kryhet në mënyrë periodike nga komisionet e përhershme, për vlerësimin e sigurimit të cilësisë dhe zyrat përgjegjëse në nivel dekanti dhe rektorati. Pyetësorët me studentët zhvillohen në mënyrë semestrale, vlerësimi i stafit dhe ai i performancës së mësimdhënies dhe kërkimit bëhet çdo vit akademik.
<b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Referuar rregulloreve dhe dokumentacionit përkatës, informacioneve specifike të paraqitur dhe vizitës në institucion, konstatohet se për vlerësimin e cilësisë, UBT ka hartuar dhe zbaton manualin e sigurimit të brendshëm të cilësisë ku përdoren instrumente të tilla si Organizimi dhe menaxhimi; Financimi i përshtatshëm; Politikat e qëndrueshme për rekrutimin e stafit; Procesi mësimor; Rritja e mobiliteteve të pedagogëve dhe studentëve; Prezantimi dhe zbatimi i ECTS; Skema e akreditimit, zhvillimit të kurrikulës; Metodatat e reja të mësimarrjes dhe tutorimit, etj.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara,	Referuar rregulloreve dhe dokumentacionit përkatës, informacioneve specifike të paraqitur dhe vizitës në institucion, konstatohet se UBT, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit ka një metodologji të qartë që i referohet standardeve shtetërore të cilësisë në arsimin e lartë. Rekomandohet që ky proces të jetë i dokumentuar më mirë.

rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.				
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	Referuar rregulloreve dhe dokumentacionit përkatës, informacioneve specifike të paraqitur dhe vizitës në institucion, konstatohet se UBT, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit bachelor në Financë Kontabilitet, përdor sondazhe të studentëve, intervista në panairin e karrierës, anketime nga të diplomuar në UBT për të vlerësuar performancën e programit të studimit. Rekomandohet që ky proces të jetë më intensiv dhe i dokumentuar më mirë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi VI.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Referuar rregulloreve dhe dokumentacionit përkatës, informacioneve specifike të paraqitur dhe vizitës në institucion, konstatohet se UBT, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë përfshin njësitë akademike, personelin, studentët dhe aktorë të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të	Referuar rregulloreve dhe dokumentacionit përkatës, informacioneve specifike të paraqitur dhe vizitës në institucion, konstatohet se UBT i përcakton qartë përgjegjësitë e detyrat për të gjitha palët e angazhuara për Sigurimin e brendshëm të cilësisë.





cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.				
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.	Referuar rregulloreve dhe dokumentacionit përkatës, informacioneve specifike të paraqitur dhe vizitës në institucion, konstatohet se gjatë procesit të vlerësimit të cilësisë, FEA (DFK) ka përfshirë studentët për vlerësimin e performancës në mësimdhënie dhe çdo gjë tjetër që lidhet me komunikimin e pedagogut me studentët si edhe të gjithë pedagogët anëtarë të personelit akademik dhe ndihmës që angazhohen në këtë proces. Rekomandohet që ky proces të jetë më intensive dhe i dokumentuar më mirë.			
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Referuar rregulloreve dhe dokumentacionit përkatës, informacioneve specifike të paraqitur dhe vizitës në institucion, konstatohet se cdo document/pyetësor, ka një format të caktuar, që respekton etikën, standardet profesionale, i cili miratohet paraprakisht në çdo strukturë drejtuese në UBT. Ai respekton anonimatën e studentëve dhe çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Konstatohet dhe vlerësojmë se departamenti FK ka marrëdhënie të mira me ekspertë dhe bashkëpunëtorë të jashtëm në kuadrin e sigurimit të cilësisë. Të tillë bashkëpunëtorë janë ekspertë biznesi, ata të institucioneve publike dhe të organizatave profesionale.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**Standardi VI.5**

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë**


<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të	Në bazë të evidencës së paraqitur dhe komunikimit me palët në Institucion, konstatohet se raportet vjetore si edhe i gjithë informacioni mbi politikat e sistemit të Sigurimit të Brendshëm të





Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Cilësisë janë lehtësisht të aksesueshme për të gjithë studentët dhe personelin.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Referuar rregulloreve dhe dokumentacionit përkatës, informacioneve specifike të paraqitur (Raportet vjetore të ZSCVI) dhe vizitës në institucion, konstatohet se UBT (DFK) publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.			
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Referuar rregulloreve dhe dokumentacionit përkatës, informacioneve specifike të paraqitur dhe vizitës në institucion, vlerësojmë se DFK harton plane masash për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Referuar rregulloreve dhe dokumentacionit përkatës, informacioneve specifike të paraqitur dhe vizitës në institucion, rezulton se UBT (DFK) vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. Rekomandohet që ky proces të jët më intensiv dhe i dokumentuar më mirë.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Referuar rregulloreve dhe dokumentacionit përkatës (planin strategjik të UBT, 2016-2022), informacioneve specifike të paraqitur dhe vizitës në institucion, rezulton se UBT harton periodikisht raportet e veprimtarisë institucionale që përmbledhin analizën e procesit mësimor, si dhe raportin e analizës së kërkimit. UBT ndërgjegjëson studentët dhe personelin, për rëndësinë dhe sigurimin e cilësisë në universitet.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X



**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Financë Kontabilitet” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor i Tiranës”**

**Pikat e forta dhe afirmime:**


1. Pjesa më e madhe e personelit akademik zotëron tituj akademikë dhe eksperiencë të gjatë shërbimi në borde drejtuese të rëndësishme si Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, Banka e Shqipërisë dhe Kryesia e Shoqatës së Financierëve dhe Kontabilistëve të Shqipërisë. Këto pasuri intelektuale vlerësohen si mjaft të rëndësishme për mbarëvajtjen cilësore të programit të studimit
2. Sistemi i administrimit të informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit është mjaft eficient dhe i saktë.
3. Programi i studimit vlerësojmë se mbështetet mjaft mirë nga kurrikula që përditësohet sistematikisht, nga një Kampus universitar i bollshëm si edhe nga salla të mirëpajisura leksioni e seminari.

**Pika të dobta:**

1. Konstatojmë mbingarkesë mësimore për një pjesë të konsiderueshme të personelit akademik.
2. Mbështetja financiare e personelit akademik për kërkimin shkencor është e ulët.
3. Institucioni ka numër të pakët marrëveshjesh me institucionet homologe të vendit e të huaja. Një pjesë e marrëveshjeve egzistuese nuk janë substanciale.

**Rekomandime:**

1. Institucioni duhet të marrë masa për rekrutimin e personelit të ri.
2. Rekomandojmë që në planin financiar të institucionit të parashikohet një shumë mbështetëse për aktivitetet e kërkimit shkencor të personelit akademik të programit.
3. Institucioni duhet të jetë më aktiv në bashkëpunimin me institucionet homologe të vendit e ato të huaja me synim lidhjen e marrëveshjeve më të shumta e më substanciale të bashkëpunimit.
4. Brenda një kohe të shkurtër duhet siguruar që të dhënat e personelit të jenë të përditësuara dhe të mbajtura me rregull të plotë.



*Kadri*

## Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

